



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 720/ Prot.

Tiranë, më 12 . 05. 2025

Lënda: Rekomandim për projektvendimin “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendim nr. 777, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë.”.

MINISTRISË SË BRENDASHME

Adresa: Bulevardi Dëshmorët e Kombit Nd. 1, Tiranë 1001

TIRANË

Në përgjigje Tuajës nr. 3007/1 Prot, datë 30.04.2025,¹ me lëndë “Dërgohet për mendim një projektvendim”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me statusin e institucionit të pavarur publik, dhe në zbatim të nenit 32, pika 1, germa “ë”, të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili parashikon: “Komisioneri ka kompetencë t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues”, pasi u njoh me propozimin e paraqitur “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendim nr. 777, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë” dhe realacionin shpjegues të tij, parashtron rekomandimet e tij ligjore përsa vijon:

Në nenin 158, pika 13 të Vendimit nr. 777, datë 15.12.2021 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se:

Neni 158

Etika dhe profesionalizmi

“13. Punonjësi gjatë veprimtarisë së përditshme duhet të zbatojë normat e sjelljes, si më poshtë vijon:

- a) të ketë sjellje të mirë dhe korrekte në jetën private, në mënyrë që të mos cenohet imazhi i punonjësit të Gardës;*
- b) të mos përdorë uniformën në ambiente publike që nuk kanë lidhje me detyrën që kryen;*
- c) të mos përdorë informacionin konfidencial, të marrë gjatë kryerjes së detyrës apo për shkak të saj, për interes personal;*
- ç) të mos përdorë apo ekspozojë pajisje/shenja dalluese të Gardës, si dhe i ndalohet vënia e tyre në dispozicion të personave të tjerë;*

¹ Administruar me tonën me nr. 720 Prot, datë 02.05.2025.

d) të mos përdorë uniformën, pajisjet e tjera në përdorim apo autoritetin e funksionit për arsye që nuk lidhen me shërbimin/detyrën ose për përfitime/privilegje të ndryshme për vete ose për të tjerët;
dh) të mos angazhohet dhe të mos marrë pjesë në asnjë veprimtari politike, partiake, sindikale, tubime, mitingje;

e) punonjësi në të gjitha nivelet është personalisht përgjegjës për pasojat e veprimeve të tij.”

Sa më sipër është propozuar ndryshimi i kuadrit rregullator, referuar projektvendimit “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendim nr. 777, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandon:

1. Ndryshimin e nenit 158, pika 13, shkronja “dh”, të Vendimit nr. 777, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë”, duke shtuar ndalimin e punonjësit të Gardës së R.Sh. për të shprehur publikisht bindjet apo preferencat e tij politike, në rrjete, media online apo platforma sociale. Konstatimet për publikime të tilla, nëse janë të bazuara në indicie të qenësishme, mund të përbëjnë bazë për nisjen e një ecurie disiplinore ndaj punonjësit të Gardës së R.Sh. Megjithatë, kujdes duhet patur në drejtim të saktësimit dhe vërtetimit nëse ky punonjës është i njëjtë me përdoruesin e asaj llogarie në rrjetet e sipërcituara, në çdo rast që përbën indicie për nisjen e një ecurie disiplinore.
2. Shtimin e shkronjës “ë” në pikën 13, të nenit 158, të Vendimit nr. 777, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë”, pas shkronjës “e”, të këtij neni, duke pasur në vëmendje lirinë dhe të drejtat e punonjësve të Gardës së Republikës për të marrë pjesë në veprimtari sindikale, me përmbajtje si vijon:

“13. Punonjësi gjatë veprimtarisë së tij, zbaton rregullat, si më poshtë vijon:...

ë) Punonjësi ka të drejtë të anëtarësohet dhe aktivizohet në organizata sindikale dhe organizatat e punëdhënësve, duke zbatuar parimin e ndalimit të diskriminimit në lidhje me anëtarësinë dhe pjesëmarrjen në veprimtari sindikale, në përputhje me rregullat e caktuara në Kodin e Punës dhe legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi;”.

Rekomandimet ligjore vijnë në përputhje me Vendimin Nr. 188, datë 27.06.2024 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nëpërmjet të cilit rekomandohet Këshilli i Ministrave, që në respektim të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, të marrë masat për rishikimin dhe riformulimin në mënyrë objektive, të justifikuar dhe të qartë, të parashikimeve të nenit 158, pika 13/dh të VKM-së nr. 777, datë 15.12.2021 “Për miratimin e Rregullores së Gardës”, duke pasur në vëmendje lirinë dhe të drejtat e punonjësve të Gardës së Republikës për të marrë pjesë në veprimtari sindikale.

Për këtë arsye, sugjerojmë që në relacionin shpjegues të projektvendimit “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendim nr. 777, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores

së Gardës së Republikës së Shqipërisë”, të shtohet në Kreun II të tij, institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi ky akt vjen edhe si rezultat i rekomandimit të tij.

III. KONKLZIONI

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa “ë”, të Ligjit Nr. 10221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në Vendimin nr. 777, datë 15.12.2021 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

REKOMANDON:

1. Rishikimin e pikës 2 të projektvendimit dhe ndryshimin e nenit 158, pika 13, shkronja “dh”, të Vendimit nr. 777, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë”, duke shtuar ndalimin e punonjësit të Gardës së R.Sh. për të shprehur publikisht bindjet apo preferencat e tij politike, në rrjete, media online apo platforma sociale.
2. Rishikimin e pikës 3 të projektvendimit dhe shtimin e shkronjës “ë” në pikën 13, të nenit 158, të Vendimit nr. 777, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë”, pas shkronjës “e”, të këtij neni, me përmbajtje si vijon:
“13. Punonjësi gjatë veprimtarisë së tij, zbaton rregullat, si më poshtë vijon:…
ë) Punonjësi ka të drejtë të anëtarësohet dhe aktivizohet në organizata sindikale dhe organizatat e punëdhënësve, duke zbatuar parimin e ndalimit të diskriminimit në lidhje me anëtarësinë dhe pjesëmarrjen në veprimtari sindikale, në përputhje me rregullat e caktuara në Kodin e Punës dhe legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi;”.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin Tuaj,

KOMISIONERI



